


CFRR >>
Centre for Financial
Reporting Reform




PULSAR 



Konferenca Ministrore 2022

KOMUNITETI I PËRBASHKËT I PRAKTIKËS SË EDUKIMIT DHE RAPORTIMIT FINANCIAR PULSAR PUNËTORIA E 6-TË

1 dhjetor 2022 • Vjenë, Austri





Konferenca Ministrore 2022

KOMUNITETI I PËRBASHKËT I PRAKTIKËS SË EDUKIMIT DHE RAPORTIMIT FINANCIAR PULSAR PUNËTORIA E 6-TË

1 dhjetor 2022 • Hotel Marriot Vjenë, Austri

PARATHËNIE

Programi PULSAR, i nisur në vitin 2017, është një program rajonal dhe në nivel vendi për 13 vende përfituese në Evropë dhe Azinë Qendrore. Objektivi i tij është të mbështet përmirësimin e kontabilitetit të sektorit publik (KSP) dhe kornizat e raportimit financiar të vendeve pjesëmarrëse në përputhje me standardet ndërkombëtare dhe në përputhje me praktikat më të mira, për të përmirësuar llogaridhënien, transparencën dhe performancën qeveritare.

Objektivat dhe qëllimi i Programit PULSAR përcaktohen bashkërisht nga partnerët – Austria, Zvicra dhe Banka Botërore – të cilët gjithashtu ofrojnë mbështetje institucionale për zbatimin e tij dhe mobilizimin e burimeve të nevojshme për aktivitetet e tij. Vendet përfituese ndihmojnë në formimin e Programit PULSAR përmes platformave të bashkëpunimit rajonal dhe kontributeve për të dyja Komunitetet e Praktikës (CoP): Komuniteti i Praktikës së Raportimit Financiar (FinCoP) dhe Komuniteti i Praktikës së Edukimit (EduCoP).

Konsolidimi është një nga proceset thelbësore dhe, në të njëjtën kohë, më sfiduese për sa i përket zbatimit të reformave të KSP. Edhe pse SNKSP ofrojnë udhëzime specifike për konsolidimin, e cila përdorin një perspektivë ekonomike që bazohet në konceptin e kontrollit, për shkak të organizimit të ndërlikuar të sektorit publik dhe gamës së gjerë të subjekteve të decentralizuara dhe entiteteve nënkombëtare, perspektiva të tjera kanë dalë nga fushëveprimi që përcaktohet nga kornizat referente ekzistuese ndërkombëtare. Për shembull, nga një këndvështrim organizativ dhe ligjor, konsolidimi i PSA bëhet sipas strukturës organizative të përcaktuar me legjislacion. Nga ana tjetër, Financat e Qeverisë

Korniza statistikore e financave qeveritare e Fondit Monetar Ndërkombëtar ndjek një perspektivë statistikore dhe kufizon shtrirjen e përpilimit të statistikave duke grupuar njësitë institucionale në sektorë dhe nën sektorë.

Standardet Ndërkombëtare të Edukimit (IES) paraqesin parimet, konceptet dhe përkufizimet që përmirësojnë edukimin e kontabilitetit për profesionistët aktualë dhe ata që aspirojnë të bëhen të tillë. Standardet adresojnë hyrjen në profesionin e kontabilitetit, zhvillimin e vazhdueshëm profesional për kontabilistët profesionistë dhe partnerët e angazhimit. Seksioni EduCoP i punëtorisë do të fokusohet në zbatimin e zhvillimeve të fundit në SNE në vendet përfituese. Gjithashtu do të diskutohen temat e lidhura dhe sfidat e fundit dhe mundësitë e sfidat për edukatorët e kontabilitetit në mbarë botën.

Objektivat kryesore të këtij seminari të parë që nga fillimi i pandemisë do të fokusohen në:

- Prezantimi i produktit më të ri të njohurive të PULSAR mbi “Konsolidimi i Pasqyrave Financiare në nivele të ndryshme të qeverisjes”;

- Kuptimi i kërkesave të kontabilitetit dhe praktikave të mira në lidhje me konsolidimin e pasqyrave financiare në nivele të ndryshme të qeverisjes
- Paraqitja e përvojave të vendeve të ndryshme në drejtim të konsolidimit të pasqyrave të tyre financiare
- Diskutimi i përvojave rajonale me zbatimin e Standardeve Ndërkombëtare të Edukimit (SNE)
- Diskutimi i hapave të mëtejshëm për programet e punës EduCoP dhe FinCoP
- Takimi i drejtpërdrejtë pas një pauze trevjeçare.

Përkthimi do të jetë i disponueshëm në shqip, boshnjakisht/kroatisht/serbisht dhe rusisht.

AGJENDA

08:00 — Regjistrimi dhe kafe

09:00 — Hyrje në agjendën e ditës

Folësit

- **Dan Boyce**, Menaxher i praktikës për Evropën Lindore dhe Azinë Qendrore, Praktika Globale e Qeverisjes, Udhëheqës i Komisionit Drejtues në PULSAR, Banka Botërore
- **Dmitri Gourfinkel**, Specialist i lartë i menaxhimit financiar, Udhëheqës Ekipi në PULSAR FinCoP, Banka Botërore
- **Jose Simon Rezk**, Specialist i lartë i menaxhimit financiar, Udhëheqës Ekipi në PULSAR EduCoP, Qendra për Reformën e Raportimit Financiar (QRRF), Banka Botërore

Temat në fokus

Fjalë hyrëse dhe njoftim i shkurtër me temat

09:15

Konsolidimi në nivele të ndryshme qeveritare: Praktikrat me të mira ndërkombëtare

Folësit

- **Ross Smith**, Drejtor Teknik dhe i Programit, Bordi Ndërkombëtar i Standardeve të Kontabilitetit të Sektorit Publik (BNSKSP)
- **Sage De Clerck**, Ekonomist i Lartë, Departamenti i Çështjeve Fiskale, Fondi Monetar Ndërkombëtar (FMN)
- **Andreas Bergmann**, Drejtor, Departamenti i sektorit publik, Fakulteti i menaxhimit dhe drejtësisë, Universiteti i Shkencave të Aplikuara të Cyrihut (ZHAW)
- **Durlandy Andrés Cubillos Márquez**, bashkëpunëtor kërkimor, ZHAW
- **Dmitri Gourfinkel**, Specialist i lartë i menaxhimit financiar, Udhëheqës Ekipi në PULSAR FinCoP, Banka Botërore
- **Giuseppe Grossi**, Studiues i lartë/Profesor hulumtues i kontabilitetit i Universitetit Nord (Norvegji); Profesor në menaxhim publik dhe kontabiliteti i Universitetit Kristianstad (Suedi)
- **Thomas Müller-Marqués Berger**, Partner auditimi dhe Drejtues global i BNSKSP, Ernst & Young; Kryetar i Grupit Këshillues Konsultativ të BNSKSP

Temat në fokus

Në këtë sesion do të diskutohen qasjet e ndryshme në lidhje me konsolidimin nga perspektivat e ndryshme duke përfshi edhe kornizën regullative, fushëveprimin dhe aplikimin praktik. Produkti më i fundit nga PULSAR mbi konsolidimin poashtu do të prezantohet gjatë seancës.

Moderator

- **Arman Vatyan**, Specialist kryesor i menaxhimit financiar, Menaxher i Programit PULSAR, Banka Botërore

11:00 — Kafe dhe pushim për rrjetëzim

11:30 — **Konsolidimi: Përvojat e vendeve dhe mësimet e nxjerra**

Folësit

- **Davit Gamkrelidze**, kreu i Thesarit të Shtetit, Ministria e Financave, Gjeorgji
- **Dritan Fino**, Drejtor, Drejtoria e Harmonizimit të Menaxhimit Financiar, Kontrollit dhe Kontabilitetit, Ministria e Financave dhe Ekonomisë, Shqipëri
- **Liudmyla Haponenko**, Drejtore e kontabilitetit, Departamenti i metodologjisë dhe mbështetja rregullative e auditimit, Ministria e Financave, Ukrainë
- **Oscar Gustavo Nuñez Del Arco Mendoza**, Drejtor i përgjithshëm i kontabilitetit publik, Ministria e Financave, Peru, dhe Kryetar i forumit të kontabilistëve të përgjithshëm të Amerikës Latine (FOCAL) [nëpërmjet video]

Moderator

- **Dmitri Gourfinkel**, Specialist i lartë i menaxhimit financiar, Udhëheqës Ekipi në PULSAR FinCoP, Banka Botërore

Temat në fokus

Ky sesion do të diskutojë konceptin e konsolidimit nga perspektiva e praktikave me të mira dhe përvojave vendore.

13:00 — Dreka

14:00 — **EduCoP: Zhvillimet e fundit në standardet ndërkombëtare të Edukimit**

Folësit

- **Jon Hooper**, Konsulent, Banka Botërore
- **Sarah Gagnon**, Menaxhere e lartë e marrëdhënieve, Federata Ndërkombëtare e Kontabilistëve (FNK)
- **Jelena Misita**, Anëtare e Bordit të Bashkësisë të kontabilistëve, auditorëve dhe profesionistëve financiar në Federatën e Bosnjës dhe Hercegovinës (UAAFWF), Udhëheqëse e grupit këshillues dhe të zhvillimit të organizatave profesionale në FNK

Moderatore

- **Natalia Konovalenko**, Konsulente me afat të gjatë për raportim financiar, Anëtare e ekipit të PULSAR EduCoP, Banka Botërore

Temat në fokus

Seanca do të diskutojë mbi informatat kryesore nga seminarët të mbajtura së fundmi mbi azhurnimet për SNE dhe rezultatet e anketës së EduCoP mbi implementimin dhe reflektimin në kurikulën e kontabilitetit. Prezantimet do të përcillen me një diskutim në grup për rastet e përzgjedhura nga vendet anëtare.

16:00 | Kafe dhe pushim për rrjetëzim

16:30 | Diskutim i planit të punës: Hapat e rradhës

Folësit

- **Dmitri Gourfinkel**, Specialist i lartë i menaxhimit financiar, Udhëheqës Ekipi në PULSAR FinCoP, Banka Botërore
- **Jose Simon Rezk**, Specialist i lartë i menaxhimit financiar, Udhëheqës Ekipi në PULSAR EduCoP, QRRF, Banka Botërore

Temat në fokus

Diskutimi i hapave të rradhës duke përfshirë aktivitetet e reja, datat dhe temat për konferencën e rradhës dhe produktet e njohurive.

17:25 | Konkludimet e takimit

Folës

- **Arman Vatyan**, Specialist kryesor i menaxhimit financiar, Menaxher i Programit PULSAR, Banka Botërore

Temat në fokus

Përmbyllja e takimit

17:30 | Mbyllja e forumit

19:00 | Darkë grupore në Kahlenberg
22:00 |

QRRF KREMTON
15-VJETORIN E
THEMELIMIT SI PJESE
E KONFERENCËS
MINISTRORE 2022



PROGRAMI PULSAR

MENAXHOHET NGA




CFRR 
**Centre for Financial
Reporting Reform**



BASHKËFINANCOHET NGA

 **Federal Ministry
Republic of Austria
Finance**

 **Schweizerische Eidgenossenschaft
Confédération suisse
Confederazione Svizzera
Confederaziun svizra**

Swiss Confederation

Federal Department of Economic Affairs,
Education and Research EAER
State Secretariat for Economic Affairs SECO

